



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 99

Ora: 16:30

VENDIM

“PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 57, DATË 11.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KRYETARI I BASHKISË ELBASAN”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Kryetari i bashkisë Elbasan, Z. Gledian Llatja

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr. 441, datë 05.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 349 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Kryetarit të Bashkisë Belsh, Bulqizë, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Poliçan, Prrenjas, Pustec, Roskovec, Shijak dhe Vorë për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.



BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Kryetari i Bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 57 regj., datë 11.05.2023.

Në datën 11.05.2023, pas hedhjes së shortit, u zgjodh relator për shqyrtimin e çështjes z. Koli Bele. Gjatë seancës paraprake të datës 11.05.2023, ora 16:30, pranë KQZ u administrua shkresa me nr. 4991, datë 11.05.2023, me anë të së cilës, z. Gledian Llatja deklaroi se ka hequr dorë nga kërkesa e tij ankimore.

Për këtë arsye, mbështetur në nenin 142, duke qenë se ankuesi ka hequr dorë tërësisht nga ankimi, KAS vendos pushimin e çështjes në tërësi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 57, datë 11.05.2023, të paraqitur nga Kryetari i bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar